



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2019:140922

Datë: 21.03.2024

Numri i dokumentit: 05483786

C.nr.50/2019

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, me bashkëpunëtorin profesionale Adelina Çmega, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditëses Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, kundër të paditurit A.G nga fshati Zoqisht, Komuna e Rahovecit, me objekt kontesti kthimi i mjeteve financiare, vlera e objektit të kontestit 950.00 euro, jashtë seancës, më datën 21.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET POSHTË si e palejueshme padia e paditëses Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në këtë çështje juridike, për shkak të çështjes së gjykuar - res iudicata.

Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, më datën 14.02.2019, në këtë gjykatë ndaj të paditurit A.G nga fshati Zoqisht, Komuna e Rahoveci, ka parashtruar padinë për kthimi i mjeteve financiare, vlera e objektit të kontestit 950.00 euro.

I padituri A.G, përmes parashtresës së datës 09.02.2024, e ka njoftuar gjykatën se lidhur me këtë çështje juridike është vendosur me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore Gjakovë – Dega Rahovec, C.nr.267/2019, të datës 19.09.2020. I njëjti ka theksuar se kjo lëndë sipas ankesës gjendet në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, ndërsa kopjen e aktgjykim C.nr.267/2019, të datës 19.09.2020 ja ka bashkangjitur parashtresës.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata ka vendosur që ta hedhë poshtë si të palejueshme padinë e paditëses Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në lidhje me kthimi i mjeteve financiare, në vlerë prej 950.00 euro për faktin se lidhur me këtë çështje juridike është vendosur me aktgjykimit e kësaj gjykate me numër C.nr.267/2019, të datës 19.09.2022. Ndaj këtij aktgjykimeve është ushtruar ankesë, ndërsa lidhur me këto ankesë Gjykata e Apelit ende nuk ka vendosur. Lënda e kësaj gjykate me numër C.nr.267/2019 e datës 19.09.2022 së bashku me këtë çështje

kontestimore kanë objektin e njëjtë, padia është paraqitur ndaj personit të njëjtë dhe përfshinë periudhën e njëjtë kohore.

Meqenëse të dyja çështjet paraqesin objektin e njëjtë, personin e njëjtë dhe periudhën e njëjtë kohore, gjykata vlerëson se nuk mund të hyjë ta shqyrtojë çështjen dhe këtë padi e ka hedhur si të palejueshme duke u bazuar në nenin 391 pika d) të LPK-së sipas të cilit parashihet që *“Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se: d) çështja është gjë e gjykuar (res iudicata)”*.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është mbështetur në dispozitën e nenit 450 të LPK-së.

Andaj, në bazë të gjendjes faktike dhe dispozitës së lartcekur si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 391 al. 1 pika d., të LPK-së, është vendosur sikur në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC

Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil

C.nr.50/2019, më datën 21.03.2024

Bashkëpunëtorja profesionale
Adelina Çmega

Gjyqtari
Berkan Hamza

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.